

UDHËZIM
Nr. 3/1, datë 12.3.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 24.2.2020, “PËR KRITERET,
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”; të pikës 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 5.2.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për vitin 2020”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 3, datë 24.2.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për Programin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:

1. Në kreun IV, paragrafi i dytë, fjalë “Aplikimet për të gjitha masat do të bëhen nga data 17 mars 2020 deri më 10 prill 2020.”, zëvendësohet me fjalë “Aplikimet për të gjitha masat do të bëhen në afatet e përcaktuara me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas propozimit të AZHBR-së”.

2. Kudo në këtë udhëzim fjalët “data 8.5.2020” zëvendësohet me fjalët “20 ditë pune nga data përfundimit i aplikimeve”.

3. Kudo në këtë udhëzim, me përjashtim të pikës 1, të kreut X, fjalët “data 30.6.2020.” zëvendësohen me fjalët “60 ditë pune nga data e përfundimit të aplikimeve”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Blendi Çuçi**

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj**